



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1758 Prot.

Lezhë, më 05.02. 2021

**VENDIM**

Nr 19, Datë 04 / 02 / 2021

**Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM nr.1034, datë 16.12.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për rihyrtimin e Pallatit të Kulturës \*Dedë Ndue Lazri\*, Bashkia Lezhë”; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi :**

1.Miratimin e një shtese e ndryshimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2021 në shumën 104,000,000 lekë.

1/2-Të shtohet shpenzimet në programin buxhetor “Trashëgimia kulturore, eventet artistike e kulturore në shumën 104,000,000 lekë, fond i cili do të përdoret për: a- Punime ndërtimi në shumën 101,540,493 lekë; b- Mbikqyrje punimesh në shumën 2,277,321 lekë; dhe c- Kolaudim dhe përgatitje të dokumentacionit përfundimtar në shumën 182,186 lekë.

Veprimet të kryhen në : Gr.00, Prog.08220, Kap.01, Art.231 në shumën 104,000,000 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI**

**ERNEST RAKAJ**

